



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---

Vendimi nr.59/18

Data: 15.08.2018

Në bazë të nenit 13,15,17,18,19,20, dhe çështjet procedurale bazuar në nenin 28,29,34.1 35.2, neni 50, neni 54 paragrafi 1.3 dhe 1.9 Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 8 i Plotësim Ndryshimit të Ligji nr. 04/L-226, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi 1.3 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, UA Nr.02./2011 Mbi Mënyrën dhe Kriteret Për Konstatimin e Tregut Përkates, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e datës 15.08.2018, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **LEJOHET**, realizimi i përqendrimi përmes përfitimit 100% të kontrollit nga American Hospital Tiranë, në cilësinë e blerësit **mbi** Hygea Hospital Tiranë, në cilësinë e shitësit.
- II. **Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim** obligohet të paguaj taksën administrative për Autorizimin lidhur me Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja ( tre mijë euro ).

### A R S Y E T I M

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, e paraqitur në bazë të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji nr. 04/L-226, neni 18 par 6, neni 19 par 5, neni 28, paragrafi (1,2), Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, publikimin e Njoftimit për qëllimin e realizimit të përqendrimit në web faqën e AKK me datën 18.07.2018, Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 25.07.2018.

## **Njoftimi për Përqendrim ka të bëjë me:**

Blerjen e 100% të aksioneve, kontrata e lidhur më datën 06.07.2018 për shitjen dhe blerjen e të gjithë kapitalit aksionar nga American Hospital Tirana, e cila synon të blejë 100% të aksioneve që DTCAH zotëron tek Hygeia Shqipëri ( Transaksioni ) .

- Parashtruesi i këtij njoftimi është American Hospital sh.a, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, në datën 17.02.2006, me NUIS K6182100C( tutje ref. AH ). AH kryen investime dhe shërbime në fushën e mjekësisë dhe shëndetit, menaxhon spitale dhe klinika private. AH është aksionar i vetëm i shoqërisë American Hospital Kosova Sh.P.K., me nr. regjistrimi të biznesit 70789396, me adresë të regjistruar në Rr.Shkupi, nr.25, Prishtinë ( tutje ref. A.H.K ), **në cilësinë e blerësit.**

### ndërsa

Hygeia Hospital Tirana sh.a, e themeluar sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë me datën 25.04.2007, me NUIS K71822007C ( tutje ref, Hygeia Tirana ose HHT ). Të gjitha aksionet e Hygeia Tirana zotërohen nga Diagnostic and Therapeutic Center of Athens Hygeia SA, një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjit grek, me nr. identifikues 094027767 ( tutje ref. "DTCAH"). Hygeia Tirana ushtron aktivitetin e saj në Shqipëri në fushën e ofritit të shërbimeve shëndetësore. Hygeia Tirana nuk ushtron aktivitetin e saj në Republikën e Kosovës edhe pse në Kosovë ka themeluar degën e kompanisë së huaj "Hygeia Hospital Tirana Branch in Kosovo" me nr. te regjistrimit të biznesit 810012188 dhe me adresë Rr. " Edit Durham ", nr. 14 Prishtinë (tutje ref. Hygeia dega ne Kosovë që ka të bëjë vetëm me hulumtimin e tregut dhe matja e opinionit publik ( sondazhet ), **në cilësinë e shitësit.**

## **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit**

Sipas nenit 15, të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi i blerësit (grupi) duke përfshirë edhe AHK (degë e huaj e regjistruar në Kosovë) përmbush kriteret për realizimin e përqendrimit,
- b) Kontrata ndërmjet palëve, është lidhur 6 Korrik 2018,
- c) Shitësi nuk ka qarkullim në Republikën e Kosovës,( ka degë të huaj të regjistruar në Kosovë).

## **Pjesëmarrësit në Përqendrim:**

### **Blerësi**

American Hospital sh.a. ( GRUPI ),zotërohet nga Balkan Alliance Healthcare me bazë në Hollandë
--

Nr. i regjistrimit : K61821002C
---------------------------------

Adresa : Rruga " Sabaudin Gabrani nr.2, Tiranë, Shqipëri
--

Fusha e veprimtarisë : AH kryen investime dhe shërbime në fushën e mjekësisë dhe shëndetit, menaxhon spitale dhe klinika private.

**Të Hyrat/Qarkullimi për vitin 2017: Totali në Lek [REDAKTUAR] KONVERTUAR në Euro është; [REDAKTUAR] mln/euro ( së bashku me AHK sh.p.k Kosovë )**

### **Shitësi/Objektivi**

DIAGNOSTIC AND THERAPEUTIC CENTER OF ATHENS "HYGEA S.A"

Nr. i regjistrimit : E themeluar sipas ligjeve të Greqisë me nr.regjistrimi 279901000 dhe me nr.tatimor ID 094027767 dhe HHT sh.a e themeluar sipas ligjeve te Shqipërisë me NUISK7189396 me seli ne Tiranë.

Adresa : në Greqi – Erythrou Stavrou str.Kifisias Av.151 23 Marusi,Athine,në Kosovë "Hygeia Hospital Tirana Branch in Kosovo" me nr. të regjistrimit të biznesit 810012188 dhe me adresë, Rr. " Edit Durham ", nr. 14 Prishtinë

Fusha e veprimtarisë : Hygeia Tirana ushtron aktivitetin e saj në Shqipëri në fushën e ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

**Të hyrat/Qarkullimi për vitin 2017 :Totali në Lek [REDAKTUAR] KONVERTUAR në EUR\ është [REDAKTUAR] mln/euro (në Kosovë nuk figurojnë të hyra sepse përfaqësia e HHT merret vetëm me matje të opinionit / sondazhe**

### **Struktura e Tregut**

Bazuar në kontratën e shitblerjes, shitësit do të shesin dhe transferojnë tek blerësit të gjitha aksionet (100 %) tek blerësit. Në përfundim të transaksionit të propozuar, Blerësi do të bëhet zotërues i të gjitha të drejtave dhe detyrimet, që burojnë nga zotërimi i aksioneve të HHT me seli në Tiranë / Shqipëri.

Sa i përket çmimit të transaksionit palët për këtë qështje në Kontratë janë dakorduar që të jetë konfidencial, ndërsa lidhur me këtë LMK rrjedhimisht udhëzimi administiv i përqendrimeve nuk parasheh detyrim për transparencën e çmimit. Më poshtë në formën tabelare gjeni strukturën e tregut në Republikën e Shqipërisë.Struktura e tregut të palëve në përqendrim per vitin 2017 (pasqyrat financiare) tregojnë se American Hospital Tiranë përfaqëson strukturën prej 7% të tregut ndërsa Hygea Hospital Tiranë përfaqëson strukturën prej 5% në tregun e shërbimeve spitalore .

**Vëmendje:** Të dhënat për AH ( blerësin ) përfshijnë edhe të hyrat nga American Hospital Kosova .

## **Tregu Relevant**

Tregu gjeografik në transaksionin e propozuar në pjesën më të madhe do të jetë Shqipëria si dhe ai ndërkombëtar( Kosova ), në formë të degës së huaj;

Tregu i produktit përfshin tregun e shërbimeve shëndetësore ( spitalore ).

## **Efektet e konkurrencës, nga transaksioni i realizuar në Tregun Përkatës**

Nga dokumentacioni i ofruar vlerësojmë se, tregu relevant, konkurrentët ekzistues apo konkurrentët e mundshëm të degës së huaj të regjistruar në Republikën e Kosovës në veçanti, strukturën dhe zgjedhjen e ofertës dhe kërkesës në treg dhe trendët e tyre, çmimin, rreziqet, pengesat ekonomike, juridike dhe pengesa të tjera për të hyrë ose për të dalë nga tregu, do të menaxhohen dhe përshtaten konform tendencave pozitive të AHT-së. Transaksioni i propozuar është transaksion që ka efekt në tregun gjeografik të ndërkombëtar duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës, e regjistruar si degë e huaj .

Nga transaksioni nuk do të rezultojnë efekte negative për konkurrencën dhe për konsumatorët në Republikën e Kosovës, sepse me këtë blerje Grupi nuk krijon pozitë të re dominuese në territorin e Shqipërisë e rrjedhimisht as në Kosovë (me degën e saj të regjistruar si American Hospital Kosova).

Me rastin e vlerësimit për arsyeshmërinë e marrjes së vendimit, Autoriteti merr parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht peshën e dëmit që mund t'u paraqiten pjesëmarrësve të përqendrimit ose palëve të treta, si dhe efekteve të konkurrencës që mund të lindin nga zbatimi i përqendrimit.

Gjithashtu theksojmë se për këtë arsye dhe jo vetëm, Autoriteti bënë publikimin e Njoftimit të Përqendrimit në webfaqe, me ç'rast konfirmojmë se nuk kemi pranuar ndonjë ankesë nga palët e treta respektivisht konkurrentët potencial të mundshëm.

**Vëmendje** - *Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës .*

***Kërkesa merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.***

Me këtë Vendim të njoftohen:

- *Pala*
- *Arkiva*

## **KOMISIONI AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS**

( \_\_\_\_\_ )  
Valon Prestreshi  
Kryetar

( \_\_\_\_\_ )      ( \_\_\_\_\_ )      ( \_\_\_\_\_ )      ( \_\_\_\_\_ )  
Ahmet Krasniq      Fatime Haziri      Muhamed Krasniqi      Shaqir Morina